

Shtyhet thirrja për aplikime për studentët e Universitetit të Tiranës në Universitetin e Studimeve të Napolit Federico II, Itali, në kuadër të programit Erasmus +, për semestrin e parë të vitit akademik 2020-2021.

Në kuadër të programit Erasmus + është shtyrë thirrja për aplikime për bursa shkëmbimi për studime për studentët e Universitetit të Tiranës në Universitetin e Studimeve të Napolit Federico II, në Itali për semestrin e parë të vitit akademik 2020-2021.

<http://www.unina.it/home>

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e studentëve për studime;

Nivelet e mobilitetit për studentët:

- Bachelor;
- Master;
- Ph.D.

Kohëzgjatja e bursave:

- Bachelor (5 muaj);
- Master (5 muaj);
- Ph.D (5 muaj).

Fushat e studimit:

- Shkenca politike;
- Të drejtat e njeriut;
- Marrëdhënie ndërkombëtare;
- Studime mbi paqen dhe konfliktet;
- Histori politike;
- Studime të politikave publike.

Për më shumë informacion referohuni linkut:

<http://www.scienzepolitiche.unina.it/>

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin mujor (850 EUR në muaj për studentët);
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni link-ut:
http://ec.europa.eu/programm.../erasmus-plus.../distance_en.htm

Studentët që përfitojnë nga mobiliteti Erasmus + nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës. Studentët do të vazhdojnë të paguajnë shkollimin e tyre dhe/ose tarifatat e regjistrimit në universitetin e tyre të origjinës.

Dokumentet e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit Bachelor:

- CV (në gjuhën angleze/ italiane në varësi të programit të studimit);
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studentit (të përkthyer zyrtarisht në gjuhën angleze/ italiane në varësi të programit të studimit);
- Listë notash (të përkthyer zyrtarisht në gjuhën angleze/ italiane në varësi të programit të studimit);
- Letër Motivimi në gjuhën angleze/ italiane në varësi të programit të studimit;
- Certifikatë e gjuhës së huaj (Anglisht/ Italisht B1);
- *Learning Agreement;

**Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Before the mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihen në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin e Studimeve të Napolit Federico II lëndë të njëjta me ato që do të kryeni në semestrin e parë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin e parë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvillohen lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës.

Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “Commitment” firmoset fillimisht nga aplikanti,

më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe më pas në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +. Nëse studenti bën ndryshime të lëndëve gjatë mobilitetit, pjesa During mobility duhet të firmoset nga personi përgjegjës në fakultet dhe më pas nga personi përgjegjës në Rektorat.

Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:

http://www.unitir.edu.al/images/Learning_agreement_for_studies_Erasmus_outgoing.docx

Dokumentet e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit Master:

- CV (në gjuhën angleze/italiane në varësi të programit të studimit);
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studentit (të përkthyer zyrtarisht në gjuhën angleze/italiane në varësi të programit të studimit);
- Listë notash dhe diplomë e nivelit Master (të përkthyer zyrtarisht në gjuhën angleze/italiane në varësi të programit të studimit);
- Listë notash dhe diplomë e nivelit Bachelor (të përkthyer zyrtarisht në gjuhën angleze/italiane në varësi të programit të studimit);
- Letër Motivimi në gjuhën angleze/italiane në varësi të programit të studimit;
- Certifikatë e gjuhës së huaj (Anglisht/ Italisht B1);
- *Learning Agreement;

**Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Before the mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihen në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin e Studimeve të Napolit Federico II lëndë të njëjta me ato që do të kryenit në semestrin e parë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillohenit në fakultetin tuaj semestrin e parë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvilloheni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës.

Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “Commitment” firmoset fillimisht nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe më pas në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +. Nëse studenti bën ndryshime të lëndëve gjatë mobilitetit, pjesa During mobility duhet të firmoset nga personi përgjegjës në fakultet dhe më pas nga personi përgjegjës në Rektorat.

Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:

http://www.unitir.edu.al/images/Learning_agreement_for_studies_Erasmus_outgoing.docx

Dokumentet e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit Doktoraturë:

- CV (në gjuhën angleze/italiane në varësi të programit të studimit);

- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studentit (të përkthyer zyrtarisht në gjuhën angleze/italiane në varësi të programit të studimit);
- Listë notash e nivelit Master (të përkthyer zyrtarisht në gjuhën angleze/italiane në varësi të programit të studimit);
- Listë notash dhe diplomë e nivelit Bachelor (të përkthyer zyrtarisht në gjuhën angleze/italiane në varësi të programit të studimit);
- Letër Motivimi në gjuhën angleze/italiane në varësi të programit të studimit;
- Certifikatë e gjuhës së huaj (Anglisht/ Italisht B1);
- Plani i kërkimit mbi tezën e PhD (i cili duhet të firmoset nga pedagogu udhëheqës në UT dhe nga një pedagog në Universitetin e Studimeve të Napolit);

-*Learning Agreement;

**Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Before the mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të marrin në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihen në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin e Studimeve të Napolit Federico II lëndë të njëjta me ato që do të kryenit në semestrin e parë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin e parë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvillohen lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës.

Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “Commitment” firmoset fillimisht nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe më pas në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +. Nëse studentit bën ndryshime të lëndëve gjatë mobilitetit, pjesa During mobility duhet të firmoset nga personi përgjegjës në fakultet dhe më pas nga personi përgjegjës në Rektorat.

Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:

http://www.unitir.edu.al/images/Learning_agreement_for_studies_Erasmus_outgoing.docx

Afati për aplikim: 19 Mars 2020

Dokumentat duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Studentët, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë nga e Hëna në të Enjte ora 10:30 – 11:30 dhe 14:30 – 16:00, si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin iro@unitir.edu.al.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të kontaktoni me Zyrën për Marrëdhëniet me Jashtë në adresën e e-mail: iro@unitir.edu.al

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!